


22.42



BASHKIA
TIRANË

Nr. Prot. 8239 / 13

Tiranë 16/3 / 2017

KONTRATE SIPËRMARRJE
OBJEKTI

“Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinat”

2017

Adresa: Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

KONTRATË SIPËRMARRJE

“Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinar”

Lidhur sot më datë 16/03/ 2017 në bazë të nenit 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, midis:

Bashkisë së Tiranës, e përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, Kryetar, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me adresë: Shëitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 2, 1001, Tiranë, që më poshtë do të quhet “**Autoriteti Kontraktor**”;

dhe

Shoqërisë “**Geci**” sh.p.k e regjistruar me Vendim Gjykatë Nr. 2840, datë 18.03.1994, me licensë profesionale të shoqërisë **NZ. 1062/21**, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me seli të shoqërisë: **Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr. 8, Tiranë**, me **NUIS K718298010** e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë **Z. Ram Geci** i mëposhtëquajtur “**Kontraktor**”.

Neni 1

Objekti i Kontratës

1.1 Objekti i kësaj kontrate është sipërmaria me objekt: “**Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinar**” në përputhje të plotë me projekt - zbatimin e objektit.

Neni 2

Vlera e Kontratës

2.1 Kontrata lidhet me një vlerë totale: **325,118,272.5** (treqind e njëzetë e pesë milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy pikë pesë) lekë me TVSH.

2.2 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 3

Afati i realizimit të punimeve

3.1 Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 28 (njëzetë e tetë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Neni 4

Gjuha e Kontratës

4.1 Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

*Neni 5
Përkufizime*

- 5.1** “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelisa ne dore.
- 5.2** “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shogëruar me cimmët per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 5.3** “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve, e vërtetuar nga enti prokurues.
- 5.4** “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjiftjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 5.5** “Cmim kontratë” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 5.6** “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 5.7** “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 5.8** “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 5.9** “Data e fillimit” eshte perfshire ne të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e nderimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 5.10** “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 5.11** “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 5.12** “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 5.13** “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 5.14** “Drejtesues projekti” do të thotë Mbikqyrësi i Punimeve i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 5.15** “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktton punët objekt i kesaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligji.

- 5.16** “Drejtor Teknik” është personi i caktuar nga Kontraktori në ofertën e tij, i cili pëmbush kualifikimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontaktues si dhe i aprovuar prej tij, i cili është personi përgjegjës nga ana e Kontraktorit për zbatimin e punimeve në Kantier deri në përfundimin e tyre, i pranishëm në kantierin e ndërtimit dhe është përfaqësuesi i Kontraktuesit në të gjitha kontaktet me përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor.
- 5.17** “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 5.18** “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 5.19** “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mesipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 5.20** “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 5.21** “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 5.22** “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 5.23** “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gjëmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.
- 5.24** “formulari i deklaramit të ofertës” - është dokumenti i plotësuar që kontraktori ka dorëzuar në datën e hapjes së tenderit dhe është pranuar nga Enti Prokurues.
- 5.25** “Data e përfundimit të kontratës” është data e vërtetuar nga Enti Prokurues.
- 5.26** “Ditët” janë ditë kalendarike dhe “muajt” janë muaj kalendarik.
- 5.27** “Ndrtyshimi” është një udhëzim që jep Autoriteti Kontraktori paparashtikuar në dokumentat fillestare dhe jepet gjithmonë me shkrim.
- 5.28** “Raste të kompensuara” janë ato që përcaktohen në pikën 33.
- 5.29** “Periudha e garancisë” së difekteve është 24 (njëzetekatër) muaj.
- 5.30** “Skica (vizatimet)” përfshijnë projektet dhe të dhëna të tjera të paraqitura ose të miratuara nga Enti Prokurues për pëmbushjen e Kontratës.
- 5.31** “Specifikimet” janë karakteristikat e punimeve të përfshira në projektet e zbatimit në dokumentat standarde të tenderit dhe çdo modifikim ose shesë e bërë dhe e miratuar me shkrim nga Investitori.

të Ndertimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantiarit ose pronave të tjera në kantiar dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

24.2 Rregulloret për certifikatat e siguracionit do ti dorëzohen Mbikqyrësit të Punimeve për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. I gjithë ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Në se Kontraktori dështon të sigurojë certifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosi të zgjasë periudhën e paraqitjes të certifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisë koston e tij nga pagesa që i jep Kontraktorit.

24.3 Ndryshime në kushtet dhe afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Investitorit.

Neni 25 Preventivi

25.1 Kontrata përfshin një preventiv për njësi. Preventivi do të përfshijë të gjitha zërat e punimeve me çmimet përkatëse të parashikuara në ofertë.

25.2 Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Kontraktori paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit me çmimin në njësi për secilin zë punimesh.

25.3 Për zërat e reja, të parashikuara në preventiv përmes dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike për çdo zë të ri pune e cila i paraqitet Mbikqyrësit të Punimeve nga Kontraktori. Mbikqyrësi i Punimeve pasi bën kontrollin e analizës teknike ia con për miratim Autoritetit Kontraktor.

25.4 Nën/zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluar nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë.

Neni 26 Negociatat dhe Amendamentet

26.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që kanë përbërë bazën e përzgjedhjes së Kontraktorit.

26.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë dhe duke u referuar shprehimisht kontratës. Çdo shtesë ose ndryshim Amendamenti do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se nënshkruhet nga të dyja palët ose nga persona të autorizuar prej tyre.

26.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, në të cilën të specifikohet data dhe të nënshkruhen nga pala ose nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.